



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 12, datë 16.10.2017

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“TERMINALI I AUTOBUZAVE KORÇË”, BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Bashkisë Korçë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Terminali i autobuzave Korçë”, Bashkia Korçë, me subjekt zhvillues Bashkinë Korçë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Korçë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

